# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-473718**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Breshëri plumbash drejt lokalit të tij në Athinë, Denis Luli kyç gojën para hetuesve |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1394454.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 27 shtator 2026, 12:26:38 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 27 shtator 2026, 12:18:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 27 shtator 2026, 12:17:00 UTC → 27 shtator 2026, 12:19:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `71ceff708ad4ec7c73ad046795034b23df2347207880d379a7861bddfab860c5` |
| TEKSTI | `b7ef90248d7c66f1bdbeb2e3f7aeefcb14ab69b889d152dd8d45cb74055ce30c` |
| PAMJA | `4c5427c7e34be08f6276b2e7d855bb8972d8bf450d9c33eaebcdb8331bcd614d` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `a04a44016abf851c960e3a1696882d5afafd68908edc57ffe4b4ff748d688c1f` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `8943aae4786784478314ed8f36e25f0bd32ee36cc85ad3e80ac7b853175904e3` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/a04a44016abf851c960e3a1696882d5afafd68908edc57ffe4b4ff748d688c1f`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Breshëri plumbash drejt lokalit të tij në Athinë, Denis Luli kyç gojën para hetuesve

Shkruar nga: I Cani | Publikuar më: 27.09.2026, 14:18

Share Share



Detaje të reja po dalin nga atentati me armë që tronditi zonën e Agios Panteleimonas në Athinë, ku një 10-vjeçare shqiptare mbeti e plagosur në këmbë.

Sipas mediave greke, objektivi i sulmit dyshohet se ka qenë pronari shqiptar i lokalit, Denis Luli, ndërsa autoritetet po hetojnë pistën e një përplasjeje të mundshme mes grupeve kriminale.

Ngjarja ka ndodhur kur katër persona të armatosur kanë mbërritur pranë lokalit me një automjet të vjedhur dhe kanë hapur zjarr në drejtim të biznesit. Dyshohet se është përdorur një kallashnikov dhe janë qëlluar rreth 25 plumba.

Pas breshërisë së armëve, autorët janë larguar me shpejtësi. Automjeti është gjetur më vonë i djegur në zonën e Aspropyrgos, ndërsa brenda tij është zbuluar edhe arma që dyshohet se është përdorur në atentat.

Mes të shtënave ka qenë edhe 10-vjeçarja, e cila ndodhej në lokal. E mitura, vajza e partneres së pronarit, u godit në këmbë dhe u dërgua në spital nga nëna e saj.

Ndërkohë, Denis Luli deri tani nuk u ka dhënë hetuesve të dhëna që mund të ndihmojnë në zbardhjen e ngjarjes. Megjithatë, mediat greke raportojnë se ai mund të kishte dyshime se ishte në shënjestër të një sulmi.

Sipas këtyre raportimeve, Luli dyshohet se i kishte kërkuar më herët një kamarieri që, nëse persona të tjerë do të pyesnin për të, të pretendonte se nuk e kishte parë.

Hetuesit po përpiqen tashmë të zbulojnë motivin e atentatit, identitetin e katër autorëve dhe nëse sulmi lidhet me një konflikt mes grupeve kriminale.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

## TË NGJASHME



Më të Lexuarat

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.